



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më _____.____.2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Shërbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS-“Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit dhe në disa njësi administrative të Bashkisë Elbasan” - Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj, i ndarë në lote si më poshtë:

- Loti I: “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit”
- Loti II: “Kryerja e shërbimit të pastrimit në disa njësi administrative të Bashkisë Elbasan”

LLOJI PROCEDURËS- “Procedurë e hapurmbi kufirin e larte monetar–shërbim”

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT -**323,732,448**(treqind e njëzet e tremilion e shtatëqind e tridhjetë e dymijë e katërqind e dyzet e tetë)**lekë pa t.v.sh**,i ndarë në lote si më poshtë:

- **Loti I: “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit”**,me fond limit **266,341,935** (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmilion e treqind e dyzet e njëmijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) **lekë pa t.v.sh**.Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.
- **Loti II: “Kryerja e shërbimit të pastrimit në disa njësi administrative të Bashkisë Elbasan”**,me fond limit **57,390,513** (pesëdhjetë e shtatëmilion e treqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e trembëdhjetë) **lekë pa t.v.sh**.Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):98341130-5 Shërbime pastrimi

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 te miratuara nga APP.

Loti I: “Kryerja e shërbimit të pastrimit në qytetin e Elbasanit”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-c) janë vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”

Pika b) eshte vendosur ne baze te nenit 30 pika 1 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrate tatimore pergjate tre viteve te fundit, 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se dyfishi i fondit limit te lotit te prokuruar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar",i ndryshuar,Kreu V,neni 41,pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese vërtetimin per taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri **2.2.1** eshte percaktuar duke u bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe referuar nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/a, nenit 47 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Duke marre ne konsiderate shërbimin objekt prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e meparshme nga AK kërkohet qe OE ofertues te paraqesin vërtetime se disponojne kapacitetet

e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Kriteri **2.2.2** është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” si dhe Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kriteri **2.2.3** është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlogaritur të kontratës së lotit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën apo kontratat e lidhura me një ent publik të shoqëruar me vërtetime për realizimin me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara. Kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara;

ose

b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 41 pika 3 dhe 42 pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme dhe besueshmëri për të zbatuar kontratën. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të

ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqese Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011” Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi licenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zerat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane të klasifikuara si jo të rrezikshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponoje një ambient të përshtatshëm për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve në pronësi/qera/forme tjeter të parashikuara nga ligji apo të paraqese një kontratë shërbimi me të trete. Ambienti duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në specifikimet teknike për kryerjen e këtij shërbimi.

Për të vertetuar sa më sipër duhet të paraqitet:

Nëse ambienti është në pronësi duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë.

Nëse është me qira duhet të paraqitet kontrata e qirase shoqëruar me dokumentacionin e përkatës të pronësive së qiradhenesit. Kontrata e qirase ku të ketë të përcaktuar objektin dhe afatin e kontratës, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Nëse operatori ekonomik do të kryejë vetë shërbimin duhet të paraqese Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për pastrim, larje kontenierësh (kodi III.1.A).

Nëse operatori do të lidhë një kontratë shërbimi me të trete duhet të paraqese kontratën e shërbimit ku të jetë përcaktuar objekti dhe afati i kontratës, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Subjekti i cili do të kryejë këtë shërbim duhet të **te jetë i pajisur me Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për pastrim, larje kontenierësh (kodi III.1.A).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) dhe pika 6 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”,VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar,Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar,Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Per mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, Ambjenti është kërkuar bazuar në shërbimin e kërkuar për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve në përputhje me kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike. Licenca me (kodi III.1.A) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohej pastrimi dhe larja e kontenierëve dhe me legjislacionin e lartepërmendur për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë.

2.3.4- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, **ku të përcaktohet tipi (emertimi teknik), lloji, marka, viti i prodhimit dhe sasia përkatëse për mjetet si me mëposhte:**

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6 - **3 (tre) copë**.
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5 - 8 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6 - **1 (një) copë**;
- c) Makinë transportuese vetëshkarkuese, me kapacitet mbartes deri 3.5ton - **3 (tre) copë**;
- d) Makinë transportuese me vinç me kapacitet mbartes deri 3.5ton - **2 (dy) copë**
- e) Makinë për larjen e rrugëve, (autobot) i pajisur me pompë për freskimin (lagjen) e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë - **1 (një) copë**.
- f) Operatori ekonomik duhet të ketë dhe keto mjete rezerve:
 - Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6,- **1 (një) copë**;
 - Makinë transportuese vetëshkarkuese, me kapacitet mbartes deri 3.5ton - **1 (një) copë**
 - Makinë transportuese me vinç me kapacitet mbartes deri 3.5ton- **1 (një) copë**

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruara në pronësiqë shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Per mjetet e deklaruara me qera qe shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë,dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi,operatori ekonomik, duhet të paraqesekontraten e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me **tipin e mjetit te porositur (emertimin teknik),llojin,marken,nr. e shasisë,vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.** Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.
- Per mjetet e paregjistruara neRepublikene Shqiperise, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerje **sipas njerit prej rasteve ne vijim:**
 - (i)mepronarin eautomjeteve.
 - (ii)me koncesionarin ose ndermjetesin ne rastin kur ka periudhe tranzitore per te pasurtedrejten e posedimit temjeteve.
 - (iii) meprodhuesin ose koncesionarin ne rastin e paraqitjes ne proceduren e prokurimit memjetete reja.

Ne tegjitha rastet subjekti duhet teparaqese dokumentacionin enevojshe, iciliverteton se subjekti qe merr persiper furnizimin emjeteve ka sipas dokumentacionit te vendit te origjines, tedrejten pertepasur nepronesi osegezuar tedrejten eshitblerjes semjeteve te paraqitura.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zera të shërbimit.

1.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6 -4 (katër) copë. Bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve që do të transportojnë (50 ton në ditë), numrin e rrugeve (2 rrugë në ditë), kapacitetin dhe numrin e konteniereve që do të perpunohen (gjithsej 558 cope) AK ka llogaritur që për të kryer shërbimin duhen **3** mjete teknologjike transportuese me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, ndërsa **1** mjet duhet rezervë për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

2.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 5-8 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6 -1 (një) copë. Eshtë kërkuar për grumbullimin e mbeturinave në rrugë ku nuk ka mundësi të futet mjeti me kapacitet 10 ton.Bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve që do të transportojnë (8 ton në ditë), numrin e rrugeve (2 rrugë në ditë), kapacitetin dhe numrin e konteniereve që do të perpunohen (gjithsej 142 cope) AK ka llogaritur që për të kryer shërbimin duhet **1** mjet teknologjik transportues me kapacitet mbajtës 5-8 ton.

3.Makinëtransportuese vetëshkarkuese, me kapacitet mbartes deri 3.5ton - 4 (katër) copë. Keto mjete janë kërkuar për largimin dhe transportin e mbetjeve urbane derë më derë, direkt nga familjaret. Bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve që do të transportojnë (8 ton në ditë), numrin e rrugeve (1 rrugë në ditë), numrin e zonave të banuara sipas lagjeve si dhe numrin e familjeve (4000 të tilla) AK ka llogaritur që për të kryer shërbimin duhen **3** mjete teknologjike transportuese me kapacitet mbajtës deri 3.5ton, ndërsa **1** mjet duhet rezervë për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

4. Makinëtransportueseme vinç me kapacitet mbartes deri 3.5 ton - 3 (tre) copë. Keto mjete janë kërkuar për largimin dhe transportin e mbetjeve inerte, mbetjeve voluminoze dhe transportin e konteniereve për larje.Bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve inerte që do të transportojnë (2 ton në ditë), sasine e mbetjeve voluminoze që do të transportojnë (2 ton në ditë) numrin e rrugeve (1 rrugë në ditë), numrin e konteniereve që do të transportohen për

larje (10 cope çdo dite), numrin e konteniereve rreth te cilave do te largohen keto mbetje (357), AK ka llogaritur qe per te kryer sherbimin duhen **2** mjete teknologjike transportuese me kapacitet mbajtës deri 3.5ton, ndersa **1** mjet duhet rezerve per zevendesim ne rast se eshte me defekt ndonje mjet.

5. Makine per larjen e rrugeve (autobot) i pajisur me pompë për freskimin (lagjen) e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë -**1 (një) copë**. Bazuar ne siperfaqet e planifikuara per freskim (lagje), normativen 1 liter/m², numrin e cikleve (2 here ne dite - 4 ore paradite dhe 4 ore pasdite), kohen e zbrasjes se autobotit, AK ka llogaritur qe per te kryer sherbimin duhet nje Autobot me kapacitet mbajtes jo më pak se 10,000 litra ujë.

2.3.5- Nje punësim mesatar prej **94** (nëntëdhjetë e katër) punonjës, per **3 muajt e fundit** të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohe tnga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqise punetore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohe qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe kane ne dispocion apo qe mund ti vihen.

Numri prej **94** punonjës ka dale si rezultat i perllogaritjes se bere per percaktimin e numrit te mjeteve, fshirjes, mirembajtjes se pjesshme dhe freskimit te rrugeve, e konkretisht:

1.Numri i mjeteve te domosdoshme per kryerjen e sherbimit gjithsej 10, pra nevojiten 10 shofere.

2.Numri i punonjesve, te cilet do te jene ne dispozicion te mjeteve do te jete 22 punonjes i ndare si me poshte:

Numri i punonjesve per cdo mjet teknologjik 5 dhe 10 ton per largimin e mbetjeve eshte llogaritur te jete 3 punonjesdhe per 4 mjete duhen 12 punonjes

Numri i punonjesve per cdo mjet 3.5 ton qe do te perdoren per largimin e mbetjeve nga shtepite e qytetareve, transportin e mbetjeve voluminoze dhe konteniereve, si dhe transportin

e mbetjeve inerte dhe mbetjeve te riciklueshme eshte llogaritur te jete 2 punonjesdhe per 5 mjete duhen 10 punonjes.

3. Numri i punonjesve te cilet do te bejne fshirjen me krahe te rrugeve, shesheve dhe trotuareve do te jete 38. Nga perlllogaritjet norma ditore e fshirjes me krahe eshte 8500m²/dite per nje punonjes dhe ne baze te sipërfaqes te planifikuar per kete sherbim duhen 38 punonjes.

4. Numri i punonjesve te cilet do te bejne mirembajtjen e pjesshme te rrugeve dhe trotuareve do te jete 21. Nga perlllogaritjet norma ditore e mirembajtjes se pjeseshme eshte 32000m²/dite dhe ne baze te sipërfaqes te planifikuar per kete sherbim duhen 21 punonjes.

5. Drejtuesi teknik i sherbimit.

6. Inxhinieri i mjedisit/eksperti ne fushen e mjedisit.

6. Një person per zyren e kontaktit me qytetaret, i cilikujdeset per mardheniet me publikun si dhe do te sherbeje edhe si pike kontakti per zbatimin ne terren te kontrates.

2.3.6- Operatori duhet te percaktoje me ane te nje deklarate nga Administratori i Shoqerise, Drejtuesin Teknik (pergjegjesin e sherbimit), per te cilin duhet te paraqese: Kontrate pune, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri **2.3.6** eshte vendosur ne baze te pikes 4, te nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me ane te ketij kriteri kerkohet qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin teknik te nevojshmem per ekzekutimin e objektit te prokurimit. Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e ketij sherbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar staf teknik si me poshte:

- 1 (një) nje punonjes te diplomuar ne Inxhinier Mjedisit ose diplome ekuivalente ne fushen mjedisore ose 1 Ekspert te certifikuar ne fushen e Mjedisit.

Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, diploma /çertifikata si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2023 - Gusht 2023.

Çertifikatat/diplomat/deshmia duhet te jene te lëshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017”Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH “ I ndryshuar.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Kriteri 2.3.7 eshte vendosur ne baze te pikes 4, te nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin teknik te nevojshmem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit qe do te realizohen dhe do te monitorohen ne vazhdimesi.Eshte kerkuar Inxhinier Mjedisi ose me diplome ekuivalente ne fushen mjedisore ose 1 Ekspert i certifikuar ne fushen e Mjedisit nisur nga nga përvoja e meparshme si dhe legjislacioni për mjedisin.Eshte vendosur periudha prej 3(tre) muajsh pasi konsiderohet e mjaftueshme qe ofertuesi te vertetoje qe ka nje vazhdimesi ne aktivitetin e perditshem dhe angazhimin e struktures se stafit drejtues.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- EN-ISO 9001(*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i ketij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.9 Operatori ekonomik të ketën stafin e tij:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Përsigurinë dhe shëndetin në punë”.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2023 - Gusht 2023.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Njëësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e shërbimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e 700 kontenierëve të mbetjeve urbane në përputhje me specifikimet teknike. Për të vërtetuar disponimin e kontenierëve operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës ose faturë zhdoganimi në emër të vet ose të qiramarrësit (në rastin kur merret me qira). Në rast se janë me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të kontenierëve, i cili duhet të jetë sa kohezgjatja e marreveshjes kuader.

Në rast se operatori ekonomik disponon kontenierët në një formë tjetër të ndryshme nga mënyrat e parashikuara më lart si dhe të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar disponimin e tyre.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i kontenierëve është llogaritur në baze të nevojave dhe prodhimit të mbetjeve nga qytetaret, zona e shërbimit të pastrimit me një shtrirje territoriale prej 1530 ha, si dhe distanca midis vend-grumbullimeve. Për këto qëllime janë përgatitur edhe hartat duke vendosur koordinatat për çdo vend-grumbullim.

2.3.11. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se në rast se shpallet fitues mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve dhe kontenierëve.** Verifikimi fizik do të bëhet përpara vlerësimit të ofertave.

Përsa mësim për operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë adrese të sakta të vendodhjes së mjeteve dhe kontenierëve që janë në pronësi apo që janë marre me qira apo formë tjetër disponimi për këto objekt prokurimi, me qëllim verifikimin e tyre përpara vlerësimit të ofertave. **Deklarimi mund të bëhet me deklaratë të vecante ose tek formulari përmbledhës i vetedeklarimit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, dhe nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Duke qene se disponimi i mjeteve dhe pajisjeve behet me deklaram, autoriteti kontraktor ka te drejten te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik, prandaj eshte kerkuar edhe deklarimi nga ana e operateve ekonomike pjesemarres deklarimi i adreses se vendndodhjes se mjeteve dhe konteniereve.

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.10) të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në parashikimet e nenit 77, pika 3, të LPP-së dhe nenit 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet që nëse një operator ekonomik oferton për më shumë se një lot duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Shënim:

1. Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën angleze si dhe t’i certifikojnë me vulën ”Apostille”. Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.
2. Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, në rastin e ofertuesve të huaj, do të paraqiten dokumenta të lëshuar sipas legjislacionit të vendit të origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklarata me shkrim.

Loti II: “Kryerja e shërbimit të pastrimit në disa njësi administrative të Bashkisë Elbasan”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-c) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondit limit të lotit të prokuruar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2023 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifave vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave

vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri **2.2.1** eshte percaktuar duke u bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe referuar nenit 42 pika 3, nenit 43 pika 2/a, nenit 47 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

Duke marre ne konsiderate shërbimin objekt prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e meparshme nga AK kërkohet qe OE ofertues te paraqesin vertetime se disponojne kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara.

Kriteri **2.2.2** është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”si dhe Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar",i ndryshuar,Kreu V,neni 41,pika c.

Kriteri **2.2.3** eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP si dhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vleres se perllogaritur te kontrates se lotit, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese kontraten apo kontratat e lidhura me nje ent publik te shoqeruar me vertetime per realizimin me sukses te kontrates, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara. Kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara;

ose

- c) **Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 41 pika 3 dhe 42 pika 3 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme dhe besueshmerine për të zbatuar kontratën.Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2Operatori ekonomik duhet te paraqese Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme(Kodi III.2.B).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”,VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar,Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar,Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Per mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi licenca me (kodi III.2.B) eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi,grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane te klasifikuara si jo te rrezikshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje nje ambjent te pershtatshem per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve ne pronesi/qera/forme tjeter te parashikuar nga ligji apo te paraqese nje kontrate sherbimi me te trete. Ambjenti duhet te plotesoje kushtet e parashikuara ne specifikimet teknike per kryerjen e ketij sherbimi.

Per te vertetuar sa me siper duhet te paraqitet:

Nese ambjenti eshte ne pronesi duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton pronesine.

Nese eshte me qira duhet te paraqitet kontrata e qirase shoqeruar me dokumentacionin e përkatës te pronesisë se qiradhenesit. Kontrata e qirase ku te kete te percaktuar objektin dhe afatin e kontrates, i cili duhet te jete i vlefshem për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Nese operatori ekonomik do ta kryeje vete sherbimin duhet te paraqese Liçensë te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per pastrim, larje kontenierësh (kodi III.1.A).

Nese operatori do te lidhe nje kontrate sherbimi me te trete duhet te paraqese kontraten e sherbimit ku te jete percaktuar objekti dhe afati i kontrates, i cili duhet te jete i vlefshem per te gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Subjekti i cili do te kryeje kete sherbim duhet te **te jete ipajisur me Liçensë te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per pastrim, larje kontenierësh (kodi III.1.A).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) dhe pika 6 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”,VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar,Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar,Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Per mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, Ambjenti eshte kerkuar bazuar ne sherbimin e kerkuar per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve ne perputhje me kushtet e percaktuara ne specifikimet teknike. Licenca me (kodi III.1.A) eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi dhe larja e konteniereve dhe me legjislacionin e lartepemendur per lejet dhe licencat ne Republikën e Shqiperise.

2.3.4- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, **ku të përcaktohet tipi (emertimi teknik), lloji, marka, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si me mëposhte:**

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 7 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6-**2 (dy) copë** .
- b) Makinë transportuese veteshkarkuese, me kapacitet mbartes deri 3.5ton- **2 (dy) copë**;
- c) Makinë transportuese me vinç me kapacitet mbartes deri 3.5ton,- **1 (nje) copë**
- d) Operatori ekonomik duhet te kete dhe keto mjete rezerve:
 - Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 7 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6, - **1 (nje) copë**;
 - Makinë transportuese veteshkarkuese, me kapacitet mbartes deri 3.5ton - **1 (nje) copë**
 - Makinë transportuese me vinç me kapacitet mbartes deri 3.5ton- **1 (nje) copë**

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruara në pronësiqë shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Per mjetet e deklaruara me qera qe shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë,dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi,operatori ekonomik, duhet të paraqesekontraten e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me **tëpin e mjetit te porositur (emertimin teknik),llojin,marken,nr. e shasisë,vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë.** Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.
- Per mjetet e paregjistruara neRepublikene Shqiperise, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerje **sipas njerit prej rasteve ne vijim:**
 - (i)mepronarin eautomjeteve.
 - (ii)me koncesionarin ose ndermjetesin ne rastin kur ka periudhe tranzitore per te pasurtedrejtjen e posedimit temjeteve.
 - (iii) meprodhuesin ose koncesionarin ne rastin e paraqitjes ne proceduren e prokurimit memjetete reja.Ne tegjitha rastet subjekti duhet teparaqese dokumentacionin enevojshem, iciliverteton se subjekti qe merr persiper furnizimin emjeteve ka sipas dokumentacionit te vendit te origjines, tedrejtjen pertepasur nepronësi osegezuar tedrejtjen eshitblerjes semjeteve te paraqitura.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zera të shërbimit.

1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 7 ton, me koeficient kompaktimi 1:4 ~ 1:6 -2 (dy) copë. Bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve që do të transportojnë (11.5 ton në ditë), numrin e rrugëve (1 rrugë në ditë secili mjet), kapacitetin dhe numrin e kontenierëve që do të perpunohen (gjithsej 293 cope nga një mjet çdo ditë) AK ka llogaritur që për të kryer shërbimin duhen **2** mjete teknologjike transportuese me kapacitet mbajtës jo me pak se 7 ton, ndërsa **1** mjet duhet rezervë për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

2. Makinë transportuese vetëshkarkuese, me kapacitet mbartes deri 3.5ton - 2 (dy) copë. Këto mjete janë kërkuar për largimin dhe transportin e mbetjeve urbane derëmë derë, direkt nga familjarët dhe largimin e mbetjeve inerte. Bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve që do të transportojnë (2 ton në ditë), numrin e rrugëve (1 rrugë në ditë), numrin e zonave të banuara sipas lagjeve (9 të tilla) si dhe numrin e familjeve (3000 të tilla) AK ka llogaritur që për të kryer largimin dhe transportin e mbetjeve urbane derë më derë duhet **1** mjetetknologjik transportues me kapacitet mbajtës deri 3.5ton. Për largimin e mbetjeve inerte bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve që do të transportojnë (4 ton në ditë), numrin e rrugëve (1 rrugë në ditë)AK ka llogaritur që duhet **1** mjet.

1 mjet duhet rezervë për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

3. Makinë transportueseme vinç me kapacitet mbartes deri 3.5 ton - 1 (një) copë. Ky mjet është kërkuar për largimin e mbetjeve voluminozedhe për transportin e kontenierëve për larje. Bazuar në kapacitetin mbartes, sasine e mbetjeve voluminoze që do të transportojnë (2 ton në ditë),numrin e rrugëve (1 rrugë në ditë) si dhe netransportin e kontenierëve për larje (10 copë çdo ditë)AK ka llogaritur që duhet **1** mjet,ndërsa **1** mjet duhet rezervë për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

2.3.5- Nje punësim mesatar prej **22** (njëzet e dy) punonjës, per **3 muajt e fundit** të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punetore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma c, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me ane të ketij kriteri kërkohet që opertoret ekonomike të deshmojnë që kanë fuqinë punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund të vihen.

Numri prej **22** punonjës ka dale si rezultat i perlllogaritjes së bëre për percaktimin e numrit të mjeteve, fshirjes së pjesëshme, e konkretisht:

1. Numri i mjeteve të domosdoshme për kryerjen e shërbimit gjithsej 5 cope, pra nevojiten minimalisht 5 shofere.

2. Numri i punonjësve, të cilët do të jenë në dispozicion të mjeteve do të jetë 12 punonjës i ndarë si më poshtë:

Numri i punonjësve për çdo mjet teknologjik 7 ton për largimin e mbetjeve është llogaritur të jetë 3 punonjës dhe për 2 mjete duhen 6 punonjës.

Numri i punonjësve për çdo mjet 3.5 ton që do të përdoren për largimin e mbetjeve nga shtëpitë e qytetareve, transportin e mbetjeve voluminoze dhe konteniereve, si dhe transportin e mbetjeve inerte dhe mbetjeve të riciklueshme është llogaritur të jetë 2 punonjës dhe për 3 mjete duhen 6 punonjës.

3. Numri i punonjësve të cilët do të bëjnë fshirjen me krahe të rrugëve, shesheve dhe trotuareve do të jetë minimalisht 2. Nga perlllogaritjet norma ditore e fshirjes me krahe është 8500m²/dite për një punonjës dhe në bazë të sipërfaqes të planifikuar për këtë shërbim duhen minimalisht 2 punonjës.

4. Drejtuesi teknik i shërbimit.

5. Inxhinieri i mjedisit/eksperti në fushën e mjedisit.

6. Një person për zyrën e kontaktit me qytetaret, i cili kujdeset për marrëdhëniet me publikun si dhe do të shërbejë edhe si pikë kontakti për zbatimin në terren të kontratës.

2.3.6- Operatori duhet te percaktoje me ane te nje deklarate nga Administratori i Shoqerise, Drejtuesin Teknik (pergjegjesin e sherbimit), per te cilin duhet te paraqese: Kontrate pune, si dhe te figurojë në listpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin drejtuesit teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri **2.3.6** eshte vendosur ne baze te pikes 4, te nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Me ane te ketij kriteri kerkohet qe opertoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin teknik te nevojshmem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.Drejtuesi Teknik i sherbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e ketij sherbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë të punësuar staf teknik si me poshte:

- 1 (një) nje punonjes te diplomuar ne Inxhinier Mjedisi ose diplome ekuivalente ne fushen mjedisore ose 1 Ekspert te certifikuar ne fushen e Mjedisit

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, diploma /çertifikata si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhen Qershor 2023 - Gusht 2023.

Çertifikatat/diplomat/deshmia duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017”Per arsimin dhe formimin professional ne R.SH “ I ndryshuar.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Kriteri 2.3.7 eshte vendosur ne baze te pikes 4, te nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatorët ekonomike te deshmojne qe kane stafin teknik te nevojshmem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e sherbimit qe do te realizohen dhe do

te monitorohen ne vazhdimesi. Eshte kerkuar Inxhinier Mjedisi ose me diplome ekuivalente ne fushen mjedisore ose 1 Ekspert i certifikuar ne fushen e Mjedisit nisur nga nga përvoja e meparshme si dhe legjislacioni për mjedisin. Eshte vendosur periudha prej 3(tre) muajsh pasi konsiderohet e mjaftueshme qe ofertuesi te vertetoje qe ka nje vazhdimesi ne aktivitetin e perditshem dhe angazhimin e struktures se stafit drejtues.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- EN-ISO 9001(*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i ketij bashkimi duhet të dorëzojë çertifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.9 Operatori ekonomik të ketën stafin e tij:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Përsigurinë dhe shëndetin në punë”.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2023 - Gusht 2023.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjësit e mësipërm do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e shërbimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë disponimin e 285 kontenerëve të mbetjeve urbane në përputhje me specifikimet teknike. Për të vërtetuar disponimin e kontenerëve operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë tatimore shitje ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara dhe emri e nënshkrimi i personit blerës ose faturë zhdoganimi në emër të vet ose të qiramarrësit (në rastin kur merret me qira). Në rast se janë me qira, kontrata e qirasë duhet të jetë noteriale dhe të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të kontenerëve, i cili duhet të jetë sa kohezgjatja e marrëveshjes kuader.

Në rast se operatori ekonomik disponon kontenierët në një formë tjetër të ndryshme nga mënyrat e parashikuara më lart si dhe të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar disponimin e tyre.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i konteniereve është llogaritur në baze të nevojave dhe prodhimit të mbetjeve nga qytetaret, zona e shërbimit të pastrimit me një shtrirje territoriale prej 1530 ha, si dhe distanca midis vend-grumbullimeve. Për këto qëllime janë përgatitur edhe hartat duke vendosur koordinatat për çdo vend-grumbullim.

2.3.11. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se në rast se shpallet fitues mjetet/pajisjet/makinëritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jenë në dispozicion gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve dhe kontenierëve.** Verifikimi fizik do të bëhet përpara vlerësimit të ofertave.

Për mëtej operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë adresë të sakte të vendodhjes së mjeteve dhe kontenierëve që janë në pronësi apo që janë marrë me qira apo formë tjetër disponimi për këto objekt prokurimi, me qëllim verifikimin e tyre përpara vlerësimit të ofertave. **Deklarimi mund të bëhet me deklaratë të vecanta ose tek formulari përmbledhës i vetedeklarimit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma ç, dhe nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Duke qenë se disponimi i mjeteve dhe pajisjeve bëhet me deklaram, autoriteti kontraktor ka të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, prandaj është kërkuar edhe deklarimi nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës deklarimi i adresës së vendndodhjes së mjeteve dhe kontenierëve.

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 2.2.1 e pikës 2.2 - Kapaciteti ekonomik dhe financiar- të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 2.3.1, 2.3.4, 2.3.5 dhe 2.3.10) të pikës 2.3 -Kapaciteti Teknik- të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa*

shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në parashikimet e nenit 77, pika 3, të LPP-së dhe nenit 42, pika 8 të VKM nr.285, dt.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet që nëse një operator ekonomik oferton për më shumë se një lot duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare si dhe kapacitetet teknike sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

Shënim:

3. Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën angleze si dhe t'i certifikojnë me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.
4. Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kriterëve të mësipërme, në rastin e ofertuesve të huaj, do të paraqiten dokumenta të lëshuar sipas legjislacionit të vendit të origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklaratë me shkrim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT